

LIGJ
Nr. 56/2017

**PËR NEGOCIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET SHTETIT SHQIPTAR
DHE KOMPANISË “AL HABTOOR INVESTMENT LLC” PËR PROJEKTIMIN DHE
NDËRTIMIN E “KULLËS IKONIKE” NË TIRANË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton procedurën për negociimin e marrëveshjes ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë “Al Habtoor Investment LLC” për projektimin dhe ndërtimin e “Kullës Ikonike” në Tiranë.

Neni 2
Procedura e negociimit

1. Procedura e negociimit të marrëveshjes të ndiqet nga Komisioni i Negocimit të Marrëveshjes, i cili kryesohet nga një përfaqësues i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ka në përbërje përfaqësues edhe nga Ministria e Financave, Bashkia e Tiranës dhe Avokatura e Shtetit.

2. Komisioni i Negocimit të Marrëveshjes të fillojë negociatat me kompaninë “Al Habtoor Investment LLC” për propozimin e paraqitur prej tyre, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 3
Miratimi i marrëveshjes

1. Komisioni i Negocimit të Marrëveshjes, në përfundim të procedurave të negociimit harton një raport, të cilin ua dërgon për shqyrtim Ministrin të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministrin të Financave.

2. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministri i Financave, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së raportit, shprehen nëse janë dakord me propozimet e paraqitura.

3. Nëse ata nuk janë dakord, ia kthejnë Komisionit të Negocimit të Marrëveshjes, me vërejtjet përkatëse.

4. Nëse ata janë dakord, vijojnë procedurat për propozimin e akteve të miratimit në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvend.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta